

L I G J
Nr.7925, datë 19.4.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991, në nenin 23, paragrafi i tretë, në vazhdim të fjalisë “Prona shtetërore që privatizohet të mos ndryshojë destinacionin e vet për 2 vjet” të shtohen fjalët: “... me përjashtim të objekteve të shërbimeve shëndetësore të stomatologjisë, farmacive, për të cilat destinacioni të mos ndryshohet për një periudhë 5-vjeçare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1088, datë 2.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha